

FABRIKA E PRODHIMIT TË MOBILEVE

“PALMA” SH.P.K.

Shillovë, Komuna Gjilan



**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR FABRIKEN E PRODHIMIT TË MOBILEVE “PALMA” SH.P.K.**

Rruga Lufta e Gjilanit 44, Komuna Gjilan

Gjilan, Prill – 2024

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR FABRIKEN E
MOBILJEV "PALMA" SH.P.K., Rruga Lufta e Gjilanit 44, Komuna Gjilan**

Parcela nr.01279-113, Zona Shillovë, Komuna Gjilan

	Emri	Hartueset e Raportit të VNM-së
Aplikuesi	Ekrem Shahini	Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari
Investitori:	"PALMA" SH.P.K. Pronar: Ekrem Shahini	
Adresa:	Rruga Bujanovcit, Komuna Gjilan	Glllogoc
Lokacioni i Fabrikës	Lufta e Gjilanit 44, Komuna Gjilan	
Tel:	+383 44 226 790	+383 49 588 634
Email:	palmamobile@hotmail.com arsim.zejnullahu@palma-mobilje.com	Blerinabajraktari1@gmail.com

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Datë:28.03.2024

Përmbajtja:

1.	HYRJE	1
1.1	Për Kompaninë.....	1
a)	Vendndodhja e Projektit.....	3
b)	Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit.....	5
c)	Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit	6
d)	Përshkrimi detal i procesit teknologjik	7
e)	Përllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit	14
2.	KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së	15
3.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME	16
4.	GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT	17
4.1	Hidrografia	20
4.2	Ndryshimet natyrore	21
5.	IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS	21
5.1	Ndikimet në ajër.....	22
5.2	Ndikimet në tokë.....	22
5.3	Ndikimet në ujë.....	22
5.4	Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë	23
5.5	Ndikimet në vendbanime dhe popullatë.....	23
5.6	Ndikimet nga zhurma.....	23
5.7	Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....	23
5.8	Ndikimi mjedisor nga mbeturinat	24
5.9	Trashëgimia Kulturore	24
6.	PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE	25
7.	PERSHKRIMI I MASAVE	27
7.1	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër	27
7.2	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë	28
7.3	Masat për mbrojtje nga zhurma	29
7.4	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë	30
7.5	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë	30
7.6	Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore.....	30
7.7	Masat rehabilituese	31

7.8	Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve	32
7.9	Menaxhimi i mbeturinave	33
8.	PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE.....	34
9.	MONITORIMI DHE RAPORTIMI	34
10.	PËRFUDNIMI	35
11.	ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMËN TABELARE:	36
12.	LITERATURA E PERDORUR	37

Lista e Figurave:

Figura 1.	Fabrika e mobileve " PALMA" SH.P.K.....	2
Figura 2	Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë “PALMA” SH.P.K.	3
Figura 3	Lokacioni i kompanisë “PALMA” SH.P.K. nga qendra e Gjilanit	4
Figura 4	Ortofoto dhe Plani i Situacionit ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë.....	5
Figura 5	Situacioni i objektit të fabrikës.....	6
Figura 6.	Sharra për prerjen e drurit.....	7
Figura 7.	Makineria ABS për ngjitjen e ngjitësit	8
Figura 8.	Makineria CNC	9
Figura 9.	Procesi i gërryerjes	10
Figura 10.	Makineria e Lyrjes dhe Tharjes	11
Figura 11.	Hapesira punuese e paketimit të mobileve	12
Figura 12	Makineria për Paketim.....	13
Figura 13.	Paketimi i Mobileve.....	13
Figura 14	Rrjeti Hidrografik i Qendre së Gjilanit me rrethine.....	21

Lista e Tabelave:

Tabela 1	Parcelat ku zhvillohet veprimtaria e fabrikës së mobileve	3
Tabela 2.	Pershkrimi i deponimit të mbeturinave sipas katalogut shtetëror.....	24

1. HYRJE

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit ne Mjedis është një dokument i rëndësishëm dhe i nevojshëm për marrjen e pëlqimit mjedisor, nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, kompania ku dhe pastaj për marrjen e lejes mjedisore dhe operimin e fabrikës se mobileve. Përmes këtij Raporti të VNM -së do të përkufizohen të gjitha ndikimet që mundë të paraqiten në relacionin e pikës së fabrikës se mobilëve dhe mjedisi jetësor duke pas parasysh mjedisin e gjerë. Hartimi i raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis bëhet me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis në fabrikën e mobilëve me objektet përcjellëse me të gjitha veprimtarit punuese (shërbim, transport, deponim, përpunim i drurit), në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit. Ky vlerësim i ndikimit në mjedis për fabrikën e mobilëve të kompanisë “PALMA” SH.P.K. ne lokacion në Rruga Lufta e Gjilanit 44, Komuna Gjilan, është punuar duke u bazuar në projektin e ndërtimit, gjendjen aktuale te lokacionit, karakteristikat e lokacionit, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth lokacionit të fabrikës si dhe dokumentit teknik ekzistues. Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së të fabrikës se mobileve kryesisht ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis si dhe propozimin e veprimeve për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative ne mjedis deri në kufijtë e lejuar. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet për mbrojtjen e mjedisit që dalin nga ky raport, duhet të merren për bazë, gjatë fazës së operimit sepse kompania ka bere ndërtimin e fabrikës se mobileve por tani pasi qe ka rrite kapacitetin e prodhimit, duhet patjetër te pajiset me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI.

1.1 Për Kompaninë

Historia e suksesit të mobilierisë Palma filloi në vitin 2000 në qytetin e Vitisë, ku nga një magazinë e thjeshtë në hapësirë prej 700 metra katrorë, me sukses bëhej shitja me shumicë dhe pakicë e mobilëve të importuara nga Italia. Kërkesa e madhe për furnizim me shumicë shtyu që Palma në vitin 2004 të zgjerohet edhe më shumë në një hapësirë prej 2500 metra katrorë. Pas 6 viteve pune të suksesshme Palma tashmë kishte fituar besimin e konsumatorëve duke ofruar gjithmonë produkte cilësore dhe dizajnë unike të mobilëve. Me qëllim që të jetë sa më afër klientëve zgjeroi aktivitetin e saj dhe në vitin 2006 hapi showroomi-n e pare në qytetin e Vitisë në një hapësirë prej 1300 metra katrorë. Gjatë kësaj periudhe shtrirja e kompanisë kaloi edhe kufijtë e Kosovës dhe në vitin 2013, u hap pika e

parë në shtetin e Zvicrës, në Spreitenbach, në një hapësirë prej 3200 metra katrorë. Hapja e kësaj pike bëri Palman të jetë kompania e vetme Kosovare që operonte në shtetin Zvicran në industrinë e mobilëve.

Mobilieria Palma zgjeroi edhe më tej aktivitetin e saj në vitin 2015 duke investuar në fabrikën prej 40.000 metra katrorë në qytetin e Gjilanit ku filloi me prodhimin e kuzhinave. Zgjerimi i kapacitetit të prodhimit bëhet çdo vit paralelisht me zhvillimin e teknologjisë duke arritur kështu një kapacitet prodhimi prej 10.000 kuzhinave në vit gjë që mundëson të jetë lider në shtetet e Ballkanit. Palma sot është e shtrirë në 60,000 metra katrorë dhe ka mbi 200 punëtorë.

Për një kohë shumë të shkurtë mobilieria Palma arriti që të bëhet prodhuesi më i madh i kuzhinave në Ballkan. Palma eksportohen në 17 vende të botës përfshirë Zvicrën, Gjermaninë, Austrinë, Dubain, Francën, Belgjikën, Greqinë e Izraelin. Krahas eksporteve ka arritur të bashkëpunojë në projekte të ndryshme me rrjete të hoteleve me renome botërore siç janë: Marriot Hotel, Bowfield, Cruachan, Hotel Stirling, Hotel Crown Plaza.

Projekti ynë i radhës do të vendos një standard të ri të showrooms në kryeqytetin e Kosovës në Prishtinë. Me mbi 30,000 metra katrorë, do të ofrojë dizajnët më unike të përcjelluara me kualitetin më të lartë të mundshëm. Në këtë mënyrë Palma do të vazhdojë të mbetet lider në industrinë e mobilëve në Kosovë, duke qëndruar afër klientëve dhe gjithmonë në hap me kohën sa i përket cilësisë dhe llojllojshmërisë së produkteve.



Figura 1. Fabrika e mobileve "PALMA" SH.P.K

Karakteristikë e fabrikës tonë është automatizimi i procesit të punës. Teknologjia e fundit që përdor Palma, fillon me zgjedhjen e lëndës së parë e cila vazhdon deri në produktin final, proces ky që udhëheqet nga ekipi profesional dhe zhvillohet duke përdorur makineritë me

standarde botërore. Cilësia është parimi ynë i parë, andaj të gjitha produktet kalojnë në një proces të kontrollit dhe testimit para se të vendosen në stok. Procesi i punës në fabrikë përfundon me radhitjen e produkteve në vendet e veçanta për eksport apo ekspozim në showroom.

Tabela 1 Parcelat ku zhvillohet veprimtaria e fabrikës së mobileve

Nr.	Nr. Parceles	Zona Kadastrale
1	P-70403064-01279-113	Shillovë

Ky raport është hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Shtojca 4. Po ashtu qëllimi kryesor i këtij raporti të VNM-së është identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis me qëllim të marrjes së masave të nevojshme për ti minimizuar ndikimet negative në Mjedis.

a) Vendndodhja e Projektit

Objektet fabrikës së mobileve nga kompania "PALMA" SH.P.K. ndodhet në ngastrat me nr. 01279-113 Zona kadastrale Shillovë, Komuna e Gjilanit. Kompania "PALMA" SH.P.K., ndodhet në pjesën perëndimore të territorit administrativ të komunës Gjilanit afër rrugës qarkore.




Figura 2 Shtrirja hapësinore e Lokacionit të Kompanisë "PALMA" SH.P.K.




Figura 3 Lokacioni i kompanisë “PALMA” SH.P.K. nga qendra e Gjiatani






Figura 4 Ortofoto dhe Plani i Situacionit ku ushtrohet veprimtaria e kompanisë

b) Përshkrimi i veçorive Fizike të Projektit

Projekti është i ndërtuar ne vitin 2015 me një sipërfaqe prej 40.000.0 m² në qytetin e Gjiilanit ku filloi me prodhimin e kuzhinave. Zgjerimi i kapacitetit të prodhimit bëhet çdo vit paralelisht me zhvillimin e teknologjisë duke arritur kështu një kapacitet prodhimi prej 10.000 kuzhinave në vit gjë që mundëson të jetë lider në shtetet e Ballkanit.

Për kompaninë, "PALMA" SH.P.K. me poshtë do ti paraqesim veçoritë fizike te këtij projekti:

Objekti me sipërfaqe prej 40.000.0 m²:

Përmbajnë:

Fabrikën e prodhimit dhe Administratën.

Fabrika përmban:

Hapësirën punuese me makineritë,

Hapësirën e montimit dhe

Hapësirën e paketimit

Fabrika e mobileve "PALMA" SH.P.K., është ne parcelën me nr. 01279-113, parcela është me qiramarrje ne shfrytëzim për 99 vjet nga Agjensioni Kadastral i Kosovës.

Kjo parcelë është e pajisur edhe me hapësira të gjelbra, hapësira për hedhjen e mbeturinave, hapësira për parkim të makinave nën 3.5 Tonë si dhe hapësira të destinuara për parkim të makinerive mbi 3.5 tonë.

c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit

Me poshtë paraqesim përshkrimin e veçorive kryesore të fazës operative të fabrikës se prodhimit te mobileve ne komunën e Gjilanit e ndërtuar nga kompania "PALMA" SH.P.K.

Administrata

Fabrika



Figura 5 Situacioni i objektit te fabrikës

Sa i përket komponentëve kryesore, për fabrikën, janë:

- Produktet e drurit,

- Energjia elektrike,
- Uji po ashtu përdoret për pastrim dhe nevoja sanitare

d) Përshkrimi detal i procesit teknologjik

Procesi i punës në prodhimin e mobilëve përfshin disa hapa të rëndësishëm. Këto hapa janë si vijon:

1. **Planifikimi dhe Dizajni:** Fillimisht, një ekip i dizajnuesve dhe inxhinierëve krijon konceptin dhe planifikon dizajnin e mobilëve të reja në përputhje me nevojat dhe preferencat e klientëve.
2. **Zgjedhja e Materialeve:** Pas planifikimit, materialet e nevojshme për të prodhuar mobilet përzgjidhen me kujdes për të siguruar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre.
3. **Prodhi:** Pas përzgjedhjes së materialeve, fillon procesi i prodhimit të mobilëve duke përfshirë:

Prerja (Sharra)- Kjo është faza fillestare e prodhimit të drurit. Sharra, që janë pjesët e mëdha të drurit, të cilat përpunojnë dhe shndërrojnë drurin në forma dhe madhësi të ndryshme. Kjo përfshin të prerjen e drurit në pjesë më të vogla me dimensione dhe forma të ndryshme për përdorimin në pjesët e ndryshme të prodhimeve.



Figura 6. Sharra për prerjen e drurit

Proceset e teknologjisë së sharrës dhe prerjes së drurit janë të ndryshme në varësi të teknikave të përdorura dhe aplikacioneve specifike industriale, por të dyja janë kritike për krijimin e produkteve të drurit cilësor.

ABS (Acrylonitrile Butadiene Styrene)- është një material polimerik që shpesh përdoret për të prodhuar pajisje dhe produkte të ndryshme, përfshirë mobilet, pajisje elektronike, lodra, dhe shumë të tjera. Një nga teknikat më të përdorura për të lidhur pjesët e ABS në prodhimin industrial është ngjitja e ngjitësit. Kjo është një mënyrë e bashkimit të pjesëve të ABS duke përdorur një substancë ngjitëse të specializuar. Këtu janë disa hollësi rreth procesit të ngjitjes së ngjitësit për ABS:



Figura 7. Makineria ABS për ngjitjen e ngjitësit

Përgatitja e Sipërfaqes: Për një lidhje të mirë të pjesëve të ABS, sipërfaqet duhet të përgatiten mirë. Kjo përfshin pastrimin dhe shpëlarjen e pjesëve për të hequr mbetjet e ndotura që mund të ndikojnë në cilësinë e ngjitjes. Pastaj, sipërfaqja mund të përpunohet me abraziv për të krijuar një strukturë të groposur që lejon ngjitësin të përhapet më mirë.

Zgjedhja e Ngjitësit: Ka ngjitës të specializuar që janë të dizajnuar për të punuar mirë me ABS-in. Këta ngjitës zakonisht janë në formë të lëngjeve ose të pastës dhe përbëhen nga materiale të cilësisë së lartë që lidhin mirë me ABS-in dhe krijojnë një lidhje të fortë.

Aplikimi i Ngjitësit: Pas përgatitjes së sipërfaqes dhe zgjedhjes së ngjitësit, ngjitësi aplikohet në pjesët e ABS që duhet të lidhen. Kjo mund të bëhet përmes shpricës, shpërndarjes me penë, ose aplikimit manual me pajisje të specializuara. Është e

rëndësishme që ngjitësi të aplikohet në mënyrë të barabartë dhe të përqendrohet në zonën e lidhjes.

Presimi dhe Ngrohja: Pasi ngjitësi është aplikuar, pjesët e ABS janë të mbledhura së bashku dhe të mbajtura së bashku me presim derisa lidhja të shkrihet. Pastaj, pjesët mund të ngrohen për të aktivizuar procesin e ngjitjes. Kjo ndihmon në shkëmbimin e molekulave midis sipërfaqeve dhe krijimin e një lidhje të fortë.

Ftohja dhe Testimi: Pas ngrohjes dhe shkrirjes së ngjitësit, pjesët janë të lënë të ftohen për të konsoliduar lidhjen. Pas ftohjes, pjesët mund të testohen për të siguruar se lidhja është e fortë dhe e qëndrueshme.

Këto janë disa hapa themelorë për ngjitjen e ngjitësit në pjesët e ABS. Procesi mund të ndryshojë në varësi të aplikacionit specifik dhe teknikave të përdorura nga prodhuesi. Është gjithashtu e rëndësishme të kuptohet se cilësia e përgatitjes së sipërfaqes dhe zgjedhja e ngjitësit kanë një ndikim të madh në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e lidhjes së pjesëve të ABS.

- CNC (Computer Numerical Control)

Makineritë CNC përdorin programim të kompjuterizuar për të drejtuar lëvizjet e saktë të mjetit të përpunimit, si p.sh., frezimi, gërrshetimi, ose prerja e pjesëve të mobileve. Përmes programit kompjuterik, prodhuesit mund të specifikojnë përpunime të saktë dhe detajuar për të krijuar pjesë të komplekse dhe të cilësisë së lartë me kosto relativisht të ulët.



Figura 8. Makineria CNC

Në kontekstin e prodhimit të mobileve, makineritë CNC përdoren për të prodhuar pjesë të ndryshme të mobilëve, si pllakat e drurit, strukturat metalike, ose pjesët e tjera të përpunuara që përdoren për të montuar mobilet. Kjo teknologji ofron precizion të lartë dhe efikasitet në prodhimin e serive të mëdha të pjesëve të mobilëve

Gërryerja- Procesi i gërryerjes është një hap kritik në prodhimin e mobilëve, duke përfshirë përpunimin e sipërfaqeve të drurit për të siguruar një pamje tërheqëse dhe një shtresë të qëndrueshme mbrojtëse.

Figura 9. Procesi i gërryerjes



Këtu janë disa hapa kryesorë të procesit të gërryerjes tek mobilet:

Përgatitja e Drurit: Para se të fillojë procesi i gërryerjes, druri duhet të përgatitet mirë. Kjo përfshin prerjen e drurit në dimensione të nevojshme dhe prerjen e pllakave ose pjatave të tjera në përputhje me dizajnin e përfunduar të mobilëve.

Aplikimi i Lëngut të Gërryerjes: Pasi pjesët e drurit janë të përgatitura, lëngu i gërryerjes aplikohet në sipërfaqet e drurit. Kjo përfshin aplikimin e një shtrese të lëngut të gërryerjes me një burim, siç është një gërshetues ose një shpërndarës.

Ngrohja dhe Presimi: Pasi lëngu i gërryerjes është aplikuar, sipërfaqet e drurit janë të ngrohura për të lejuar përdorimin e tij thellësisht në fibra të drurit. Pas ngrohjes, pjesët janë të presua së bashku për të siguruar një lidhje të fortë midis lëngut të gërryerjes dhe drurit.

Përpunimi Shtesë (Opsionale): Pas procesit të gërryerjes bazë, pjesët e mobilëve mund të nënshtrohen përpunimeve shtesë për të përmirësuar pamjen e tyre ose për të shtuar karakteristika të veçanta. Kjo mund të përfshijë pikturën, lakimin, aplikimin e materialeve të tjera dekorative, ose përdorimin e teknikave të tjera për të krijuar efekte të veçanta.

Lyrja dhe Tharja- Procesi i lyerjes, i njohur gjithashtu si pikturimi ose ngjyrosja, është një hap kritik në prodhimin e mobilëve. Ky proces jep një pamje estetike të përfunduar dhe ndikon në aspektin e përfunduar të mobilëve. Këtu janë disa hapa të procesit të lyerjes së mobilëve:

Përgatitja e sipërfaqes: Para se të fillojë procesi i lyerjes, sipërfaqja e mobilëve duhet të përgatitet mirë. Kjo përfshin pastrimin e sipërfaqes për të hequr pluhurin, grimcat, dhe

substancat tjera të ndotura. Në disa raste, sipërfaqja mund të jetë e rërësuar ose e shkrihet për të krijuar një bazë të fortë për ngjyrën.

Aplikimi i Primerit: Primeri, një shtresë bazë e ngjyrës, aplikohet mbi sipërfaqen e mobilëve për të përmirësuar adezionin e ngjyrës dhe për të krijuar një bazë tërheqëse për ngjyrën e mëtejshme.

Ngjyrosja: Pas aplikimit të primerit dhe pasi ky i fundit ka tharë, ngjyra e zgjedhur aplikohet mbi sipërfaqen e mobilëve. Kjo mund të bëhet përmes shpricës, shpërndarjes me penë, ose aplikimit manual me furçë, varësisht nga preferencat dhe procesi i prodhimit.

Aplikimi i Shtresave Të Mëtejshme: Në disa raste, është e nevojshme aplikimi i shtresave të mëtejshme për të arritur një ngjyrë tërheqëse dhe për të mbrojtur sipërfaqen. Kjo mund të përfshijë aplikimin e shtresave të qëndrueshme të lakimit ose gërshetimit për të siguruar një mbrojtje të shtuar dhe një pamje më të shkëlqyer.



Figura 10. Makineria e Lyrjes dhe Tharjes

Pas aplikimit të të gjitha shtresave të ngjyrës dhe shtresave të mëtejshme, mobilet duhet të thahen plotësisht përpara se të kontrollohen për cilësi dhe integritet. Kontrolli i cilësisë përfshin vëzhgimin e ngjyrës, përsëritjen e nevojshme të hapat nëse ka nevojë, dhe

sigurimin që mobilet të jenë gati për paketim dhe transport.

Montimi dhe Paketimi- Montimi dhe paketimi i mobilëve janë dy hapa kritikë në procesin e prodhimit dhe distribuimit të produkteve. Këto hapa sigurojnë që produktet të jenë të mbledhura saktësisht dhe të përpakëtuara në mënyrë të sigurt për transport dhe shpërndarje. Këtu janë disa hapa të procesit të montimit dhe paketimit të mobilëve:

Montimi:

- **Identifikimi i pjesëve:** Pjesët e nevojshme për montimin e mobiljeve identifikohen dhe kontrollohen për saktësi dhe integritet.
- **Montimi i strukturës:** Pjesët e mobiljeve montohen së bashku për të krijuar strukturën bazë të produktit.
- **Shtimi i detajeve:** Pjesët e vogla dhe detajet shtesë, siç janë furnituri dhe pajisjet, shtohen në strukturën bazë në këtë fazë.
- **Kontrolli i cilësisë:** Pas montimit, produkti përfundimtar është i kontrolluar për të siguruar që të gjitha pjesët janë të vendosura saktësisht dhe se nuk ka defekte të dukshme.



Figura 11. Hapesira punuese e paketimit të mobiljeve

Paketimi:

- **Përgatitja e paketimit:** Pas montimit, mobilet janë të përgatitura për paketim. Kjo përfshin pastrimin e tyre dhe sigurimin që të gjitha pjesët dhe materialeve të paketimit janë në dispozicion.
- **Përpilimi i materialeve të paketimit:** Pjesët e mobilëve janë të përpiluara së bashku me materiale të mbrojtjes, siç janë qese plastike, pllaka kartoni, ose fletë plastike për të mbrojtur sipërfaqet nga dëmtimi.

- **Etiketimi dhe identifikimi:** Çdo paket është etiketuar me informacione të rëndësishme, siç janë përmbajtja, udhëzimet për montim, dhe informacione të tjera që ndihmojnë në identifikimin e produktit.
- **Kontrolli i fundit:** Pas paketimit, mobilet janë të kontrolluara përsëri për të siguruar që çdo paket është i plotë dhe i gati për transport.



Figura 12 Makineria për Paketim



Figura 13. Paketimi i Mobileve

4. **Kontrolli i Cilësisë:** Në këtë fazë, mobilet janë nënshtruar një procesi të kontrollit të cilësisë që siguron që produktet përmbushin standardet dhe specifikacionet e përcaktuara për cilësinë, duke përfshirë pamjen, performancën, dhe qëndrueshmërinë.

5. **Transporti dhe Shitja:** Pas kontrollit të cilësisë, mobilet janë të gatshme për transport dhe shitje në treg për të plotësuar nevojat e klientëve.

Është e rëndësishme të theksohet se funksionet specifike teknologjike mund të ndryshojnë në bazë të nivelit të prodhimit, madhësisë së fabrikës dhe teknologjisë së disponueshme.

e) Përlllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit

Me poshtë do ti përshkruajmë te gjitha emetimet e pritura gjate fazës se operimit , pasi qe objekti i fabrikës është tashme i ndërtuar qe nga viti 2015:

Uji: Kualiteti i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga aktiviteti i punës duke u bazuar ne masat e marruara nga kompania, nuk do te ndikoj negativisht gjate fazës se operimit, ndotja është minimale, kompania ka ndërtuar sistemin gypor te largimit te ujerave atmosferik.. Shfrytëzimi i ujit do të përdoret për nevoja te ndryshme ne administratë ,për nevoja te tualeteve, pastrimit te dyshemesë, nevojat sanitare e higjienike. Shfrytëzimi i ujit i cili përdoret për te gjitha nevojat e kompanisë, pas përdorimit te tij do te shkarkohet në rrjetin e kanalizimit të qytetit.

Ajri: Proceset teknologjike të përdorura për prodhimin e mobilëve mund të rezultojnë në emetime të polutanteve të ajrit. Kjo mund të përfshijë gazra të ndryshëm, siç janë formaldehidi, benzeni, dhe gazrat e tjera organike të vlere. Përdorimi i materialeve të kimikateve, ngrohja e drurit ose lëndëve të tjera dhe proceset e ngjyrosjes janë vetëm disa prej faktorëve që mund të kontribuojnë në këtë lloj ndotjeje. Nuk parasheh ndonjë proces teknologjik të përpunimit të produkteve industriale apo kimike dhe realisht nuk paraqet potencial për ndikime në kualitetin e ajrit..

Dheu – kontakti i ujërave nga brenda lokacionit të projektit me ujërat sipërfaqësore është izoluar - mund të konstatohet se ndikimet në kualitetin e dheut dhe nën të janë minimale.

Zhurma –Fabrikat e mobileve janë zakonisht burime te zhurmshme dhe mund të shkaktojnë ndotje akustike për komunitetin lokal, por duke analizuar lokacionin se ku është e ndërtuar fabrika e mobileve, atëherë ndikimi i zhurmës do jete i përballueshëm.

Dridhjet – Dridhjet të tokës - tërmete me intensitet të lartë nuk ka pasur, ka pasur lëkundje nga dridhjet e tokës, por pa pasoja në njerëz dhe dëme materiale. Këto

dridhje kanë shkaktuar vetëm shqetësim. Dukuritë tjera, që shpesh ndodhin në territorin e Gjilanit, janë: rrëshqitja e dheut, akullnajat, breshëri, si dhe dukuri tjera që shkaktojnë dëme në pasuri bujqësore dhe në infrastrukturë.

Drita, nxehtësia dhe rrezatimi – Janë tri dukuri që te triat se bashku te ndihmojnë në realizimin e punës ku Lokacioni ku është ndërtuar fabrika ka drite, rrezatim diellor dhe nxehtësi të mire.

Flora dhe Fauna – Në rast se kemi derdhje apo shkarkim nga Ky aktivitet në aspektin e ndikimeve fizike në florë dhe faunë është minimal. Nuk parashihen ndikime të theksuara në florë dhe faunë.

Ndikimet sociale dhe ekonomike – Mund të thuhet se ky aktivitet nuk do të paraqes ndonjë ndikim negativ në komunitetin lokal. Përkundrazi, në fabrikë janë të punësuar mb 200 punëtorë, të cilët do të përfitojnë paga dhe mëditje të mira. Ky Projekt ndikon pozitivisht në ekonominë Vendore dhe lokale.

Llogaritja e llojit dhe sasisë së mbetjeve dhe emetimeve gjatë operimit të fabrikës së mobileve përfshin vlerësimin e faktorëve të ndryshëm dhe marrjen në konsideratë të aktivitetëve specifike që lidhen me secilën fazë.

Këtu është një udhëzim i përgjithshëm për procesin e llogaritjes:

Krijoni një sistem monitorimi për të gjurmuar emetimet e vazhdueshme dhe gjenerimin e mbetjeve, duke lejuar rregullime dhe përmirësime me kalimin e kohës.

Është e rëndësishme të theksohet se llogaritjet specifike mund të ndryshojnë në bazë të madhësisë dhe vendndodhjes së fabrikës së mobileve, rregulloreve lokale dhe disponueshmërisë së të dhënave. Konsultimi me specialistë mjedisorë dhe përdorimi i mjeteve si softueri i vlerësimit të ciklit jetësor mund të rrisë saktësinë e këtyre llogaritjeve.

2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së

Bazuar në karakteristikat e fabrikës së prodhimit të mobileve me infrastrukturë përcjellëse dhe sipas projektit (vendndodhja, madhësia e shtrirjes, ndikimet e mundshme në mjedis etj.), ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar.

Shtojca 1 e këtij ligji, paragrafi 10:

Industria ushqimore: Industria e letrës, e drurit, e tekstilit, dhe e lëkurës.

Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233
- Ligji për Mbrojtje nga Zhurma Nr. 02/L-102

Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikojë për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

3. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME

Duke e pasur parasysh se hapësira ku është ndërtuar fabrika e mobileve nga kompania "PALMA" SH.P.K. është përzgjedhur në atë mënyrë që të jete sa më afër lëvizjeve të shumta të makinerive dhe po ashtu të ruaj shëndetin e njeriut..

Me poshtë do të paraqesim disa alternativa dhe konsiderata:

Analiza e tregut: Duhet të kryhet një analizë të plotë të tregut për të identifikuar kërkesën për një fabrike të mobileve në vendndodhjen e propozuar. Merrni parasysh dendësinë e popullsisë, modelet e trafikut dhe konkurrencën në zonë.

Partneritetet me stacionet ekzistuese: Eksplorimi i partneritetet me stacionet ekzistuese të fabrikave të mobileve ose dyqanet e komoditeti. Ndërmarrjet e përbashkëta ose marrëveshjet e ekskluzivitetit mund të ofrojnë një kosto më të ulët hyrjeje dhe përgjegjësi të përbashkëta operacionale.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis: Të kryhet një vlerësim i plotë i ndikimit mjedisor për të siguruar përputhjen me rregulloret lokale dhe për të minimizuar ndikimin e mundshëm mjedisor të fabrike mobileve.

Shërbimet e ndarjes së makinës ose ndarja e udhëtimit: Vlerësimi i kërkesës për shërbimet e ndarjes së makinave ose të udhëtimit në zonë. Bashkëpunimi me shërbime të tilla ose ofrimi i hapësirave të dedikuara për to mund të jetë një alternativë.

Integrimi i Energjisë së Rinovueshme: Nëse preferohet një fabrikë për prodhimin e mobileve, duhet të merret parasysh përfshirja e burimeve të rinovueshme të energjisë, të tilla si panelet diellore, për të fuqizuar fabrikën. Kjo mund të zvogëlojë ndikimin mjedisor dhe kostot operative.

Platformat në internet dhe shërbimet e dorëzimit: Eksplorimi i platformave të internetit për shërbimet e shpërndarjes së mobilerive. Në disa zona, kërkesa për shpërndarjen e mobilerive sipas kërkesës është në rritje, dhe kjo mund të jetë një alternativë për një fabrikë të mobileve.

Stimujt e qeverisë: Hetimi i çdo stimul ose grant qeveritar për projekte të qëndrueshme ose alternative të energjisë. Qeveritë mund të ofrojnë mbështetje për projekte që përputhen me qëllimet mjedisore.

Përmirësimi i së ardhmes: Të merret parasysh qëndrueshmërinë afatgjatë e fabrikës së mobileve. Me rritjen e automjeteve elektrike dhe ndryshimin e peizazheve të energjisë, sigurohuni që modeli i biznesit të jetë i adaptueshëm ndaj ndryshimeve të ardhshme.

Zonimi dhe lejimi: Kuptimi i rregulloreve lokale të zonimit dhe kërkesat e lejeve. Kjo përfshin pajtueshmërinë me standardet e sigurisë, rregulloret e përdorimit të tokës dhe konsiderata të tjera ligjore.

Është thelbësore të angazhoheni me palët përkatëse të interesit, të kryeni studime fizibiliteti dhe të konsultoheni me ekspertë në fushat e energjisë, mjedisit dhe biznesit për të marrë vendime të informuara. Për më tepër, kërkimi i kontributit të komunitetit dhe adresimi i shqetësimeve mund të kontribuojë në suksesin e përgjithshëm, pra kompania “PALMA” SH.P.K. ka përdorur alternativën e bashkepunimit me palët e interesit dhe zgjedhja ka e lokacionit ka rezultuar me sukses mjaft të lartë dhe profitabile për kompaninë.

4. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT

Mjedisi dhe mbrojtja e tij janë ndër çështjet më shqetësuese, por edhe më prioritetet, të politik bërësve në të gjithë botën, ndërkohë që posaçërisht ngrohja globale po bëhet një shqetësim serioz për globin tokësor. Në Kosovë, çështja e mjedisit, për fat të keq, nuk ka qenë për një kohë të gjatë në listën e prioritetëve të politik bërësve. Edhe sot, mbrojtja e mjedisit ende nuk zë hapësirën dhe rëndësinë e duhur në agjendat e politik bërësve qoftë në nivelin qendror, por veçanërisht në nivelin lokal.

Në bazë të hulumtimeve dhe vlerësimeve të bëra, Gjilani ballafaqohet me probleme mjedisore të ndryshme siç janë: mungesa e ujit të pijes, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, menaxhimi jo i mirë me mbeturina, menaxhimi jo i mirë i tokës bujqësore, ndërrimi i

destinacionit të shfrytëzimit të tokës bujqësore, urbanizimi, shfrytëzimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve, prerja e pyjeve dhe mungesa e ripyllëzimeve, hapësirat e pamjaftueshme të gjelbëruara në qytet, mungesa e sistemit të monitorimit të medimeve mjedisore etj. Rrethina e Gjilanit është e pasur me xehe (hekur e leucit) dhe me burime minerale (Nasalë, Pidiq, Kmetoc, Pogragjë, Perlepnice). Gjilani dallohet nga komunat tjera me një pedologji më homogjene të tokës. Mirëpo, përkundër posedimit të këtyre xeheve dhe burimeve minerale, sektori i minierave ende nuk është i zhvilluar.

Bujqësia dhe Pylltaria: Prej gjithsej 51.500 hektarë sipërfaqe tokësore sa ka Komuna e Gjilanit me pyje dhe tokë pyjore janë të përfshira 26,560 ha (51.6%), ndërsa me tokë bujqësore 24.940 (48.4%). Pjesa më e madhe e tokës përbëhet nga dheu i mirë, i thellë dhe pjellor, duke i dhënë Gjilanit një mundësi të vërtetë për intensifikimin e bujqësisë. Prandaj, bujqësia është aktiviteti kryesor në qendrat rurale, duke prodhuar kryesisht drithëra dhe foragjere. Vetëm 4.8 % e sipërfaqes së përgjithshme të tokës së kultivuar bujqësore e regjionit të Gjilanit është nën ujtime, që zënë vendin e fundit si regjion në Kosovë . Aktualisht ekzistojnë 3200 ferma të vogla dhe 48 ferma të mëdha. Bujqësia është një ndër fushat ekonomike që ndikon në mjedis, duke bërë spërkatjen e bimëve me pesticide, herbicide dhe efekti nga plehrat kimike. Problem i rëndësishëm është ndërrimi i destinimit të përdorimit të tokave bujqësore, prerja dhe dëmtimi i pyjeve, dhe mungesa e ndonjë programi të ripyllëzimit. Infrastruktura rrugore. Numri enorm i automjeteve nëpër qytet është shkaktar i ndotjes së madhe të mjedisit.

Për më tepër, nuk ka monitorim të emisioneve të ajrit e as monitorim të cilësisë së ajrit. Zgjerimi i infrastrukturës rrugore dhe transporti gjithashtu bartin me vete efektet negative për mjedisin, për shkak të lirimit të gazrave dhe zënies së sipërfaqeve të tokës me asfalt.

Uji i pijes dhe ujërat e zeza: Lumi Morava e Binçës është lumi më i madh i kësaj komune, por ka edhe lumenj të tjerë që janë të rëndësishëm siç është lumi i Përlepnicës, mbi të cilin është ndërtuar penda me qëllim të ujit të pijshëm. Kjo pendë nuk është e mjaftueshme për furnizim të qytetarëve me ujë të pijes, prandaj një pjesë e tyre shfrytëzojnë edhe ujin nga puset. Ndërsa, vendet rurale vetëm 10% kanë qasje në ujë të pijshëm. Menaxhimin e ujit të pijshëm e bën Kompania Rajonale e Ujësjellësit “Hidromorava” Sh.A. Qyteti ka një problem të madh me kundërmimin që vjen nga ujërat e zeza si pasojë e mbulimit të shtratit të lumenjve Mirusha dhe Stanishorka dhe derdhja e ujërave të zeza në to. Kundërmimi përshkon tërë qytetin, por më shumë kanë probleme banorët që shtrihen afër rrugës për në fshatin Malishevë, si dhe banorët në pjesën periferike që njihet si “Zabeli i Sahitagës”. Të gjitha

ujërat e ndotura urbane derdhen në lumenj, për shkak se nuk kanë ndonjë impiant të pastrimit të ujërave të zeza, ndërkaq kjo i dëmton lumenjtë. Gjithashtu, problem tjetër është edhe dëmtimi i shtratit të lumenjve nga shfrytëzimi i inertëve nga shtretërit e lumenjve.

Menaxhimi i mbeturinave: Është një nga problemet më të mprehta mjedisore për këtë komunë. Kemi lloje të ndryshme të mbeturinave si ato komunale, mbeturinat e ndërtimit, mbeturinat medicinale, automjetet mbeturinë, gomat mbeturinë, vajrat mbeturinë, bateritë e hedhura. Sasia e deponimit të mbeturinave për banor është 142 (kg/vit), ndërsa sasia e përgjithshme e mbeturinave 52,120.75 ton. Kompania regjionale "Higjiena" është kompania që bën grumbullimin, bartjen dhe deponimin e mbeturinave, ndërkohë që ekzistojnë edhe disa kompani që bëjnë trajtimin e mbeturinave në këtë komunë: "Bosfor" që merret me grumbullimin e hekurit, aluminit, mesing, bateri me kapacitet 10 T/muaj, po ashtu edhe "Hekurishte" merret me grumbullimin e mbeturinave hekur, alumin, mesing, bateri. Deponia Regjionale që gjendet në Gjilan, me madhësi 24 ha, përfshinë komunat: Gjilan, Kamenicë, Viti, Novobërdë, Kaçanik, Shtime dhe Ferizaj. Gjendja në këtë deponi nuk është e mirë, sistemi i pompimit nuk funksionon rregullisht dhe si pasojë e kësaj bëhet përzierja e ujërave sipërfaqësore me ato të deponisë dhe për këtë ka ankesa të shpeshta nga banorët vendas.

Banorët që jetojnë në anën e poshtme të kësaj Deponie rajonale janë të prekur nga efektet e saj jo vetëm nga kundërmimi i erës, por edhe nga kontaminimi i ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor. Shumë burime ujore, që deri para ndërtimit të deponisë janë shfrytëzuar nga banorët vendas, tani janë të papërdorshme. Andaj, Deponia regjionale ka shkaktuar probleme të mëdha në mjedis me një efekt shumë të gjerë.

Natyra, Turizmi dhe Rekreacioni: Natyra është mjaftë e pasur me lloje bimore dhe shtazore të egra, sidomos Malet e Karadakut dhe ato të Zhegocit. (Nuk ka ndonjë hulumtim të rëndësishëm të këtij komponenti). Në Komunën e Gjilanit nuk ka sipërfaqe të mjaftueshme të gjelbëruar, megjithatë vlen të përmendet se Parku i qytetit mirëmbahet mire. Zona potenciale për zhvillimin e turizmit janë Malet e Karadakut, Zhegovcit, Kulla e Pogragjës, Shpella në Bresalc, burimi termomineral në Doberqan etj. Peshkimi dhe gjuetia si veprimtari sportive janë të organizuara përmes shoqatave. Peshkimi është një veprimtari sportive jo shumë e zhvilluar dhe zhvillohet në Liqenin e Livoqit, atë të Përlepnicës etj. Gjuetia e kafshëve të egra është e organizuar përmes shoqatës "Agim Ramadani", por nuk dihet për fondin e kafshëve të egra.

4.1 Hidrografia

Ujërat nga ky rajon derdhen në pellgun e Detit të Zi. Pjesa më e madhe e ujit rrjedhë gjatë një periode të shkurtër kohore. Rrjedhje më të mëdha të ujit shfaqenë në mars, shkurt dhe në maj, kurse më të vogla në gusht dhe shtator. Lumi më i madh Morava e Binçës buron nën masivin e quajtur Bilak që është rremb i Karadakut të Shkupit. Prurja mesatare mujore në Moravën e Binçës në mënyrë të theksuar fillon të rritet në muajin shkurt, kur prurja është më e madhe se ajo e janarit për 2,89 m³/sek në Domoroc dhe 356 m³/sek në Kërmjan. Krahësuar me muajin shkurt- mars kjo prurje në lokalitetin e parë është më e madhe për 2,35 m³/sek e në Kërmjan për 2,20 m³/sek, kur në këto lokalitete arrin lartësia më e madhe e prurjes, në muajin mars. Minimumi i prurjes është shënuar në muajin gusht në të dy lokalitetet. Prej maksimumit të prurjeskjo e gushtit është më e vogël për më se 12 herë në Domoroc dhe 8 herë në Kërmjan. Në bazë të kësaj mund të përfundohet se në Moravën e Binçës prurja më e madhe është në mars dhe në shkurt e më e vogël në gusht dhe në shtator. Degët e djathta të Moravës së Binçës janë lumi Letnica, Grykes së Karadaku, Pisjani, Llashtices, sllubices dhe Lumi Llapushas. Mirushes Dallohen si lumenj të shkurtër, të rrëmbyeshëm, me lugina të thella dhe të ngushta, me fuqi të theksuara erozive.

Degë të majta të Moravës së Binçës janë ajo e Zhitisë, Cërnica, Livoqit dhe Krivareka (Lumi i Shtrembër). Ky i fundit dallohet prej të gjitha degëve jo vetëm për nga gjatësia dhe prurja , por edhe me madhësi të pellgut (612 km²).

Veçori e përgjithshme e degëve të Moravës së Binçës është intensiteti i madh i erozionit dhe procesit të akumulimit në pjesën e poshtme të fushës së Gjilanit. Sidomos dallohet lumi i Letnicës dhe i Përlepnicës për veprimin eroziv dhe procesit të akumulimit të materialit të sjellë.




Figura 14 Rrjeti Hidrografik i Qendre së Gjilanit me rrethine

4.2 Ndryshimet natyrore

Pas ndërtimit të fabrikës së mobileve nuk ka pësuar ndryshime dhe prishje të peizazhit, sepse aty ka shtëpi dhe industri të ndryshme të cilat nuk dallojnë shumë nga investimi i bere, ndryshim në peizazh është sepse i është shtuar një objekt i ri në atë lokacion. Është bere rritja e sasisë së ujërave të shkarkuara nga, punëtorët dhe nga administrata, ndotja nga makinat lëvizëse dhe ato për bartje të mobilie dhe nevojave të ndryshme për fabrikën e mobilierisë, dhe duke e krahasuar me atë se lëvizja e makinave në rrugë magjistrale bene ndotje me të madhe se sa makinat që shfrytëzohen për nevoja të ndryshme të fabrikës.

Vlen të theksohet se edhe mbeturinat komunale bëjnë ndotje të madhe në ambient dhe natyrë, siguruar kontejnerët për mbeturina të cilat merren nga kompania e licencuar.

Sa i përket fabrikës së prodhimit të mobilëve nuk ka ndikim, investitori ka marrur të gjitha masat duke ruajtur ndotjen e ajrit, ujit apo dheut.

5. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS

Ndikimet në mjedis vijnë në shprehje kur vepron faktori antropogjen në mjedis, vetëm se në shkallë të caktuar duke filluar nga minimumi real i këtij ndikimi. Duke u bazuar në analizën e ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqesim në këtë rast një analizë më të hollësishme të

ndikimeve të mundshme në mjedis duke specifikuar edhe masat zbutëse që do të përdoren për të eliminuar apo për të i minimizuar këto ndikime.

Gjatë punës kontinuele të fabrikës së mobileve vjen deri te rritja e emisionit të materieve ndotëse nga puna e automjeteve, pluhuri i shkaktuar nga përpunimi i drurit, lirimi i aromave të ndryshme nga përdorimi i ngjyrave, krijohet zhurmë nga makineritë punuese. Në mënyrë indirekte mund të vjen edhe te deri te ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe sipërfaqeve të dheut afër nëse kemi prishje të kamionëve për bartje.

Analiza e VNM-së në këtë rast realizohet duke u bazuar në projektin kryesor të përfunduar më lart në këtë raport si dhe nga gjendja reale në lokacionin respektivisht zonën ku është ndërtuar fabrika e mobileve nga **“PALMA” SH.P.K.** Kjo analizë kryhet me qëllim të vlerësimit të ndikimit në mjedis në dobi të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit duke mos i cenuar aspektet: kimike-fizike (ndikimet në burimet natyrore dhe degradimi fizik i mjedisit), biologjike-ekologjike (ruajtja e biodiversitetit, ndikimi mbi jetën e gjallë dhe biosferë) dhe socio-ekonomike (ndikimet e përkohshme apo të përhershme pozitive apo negative).

5.1 Ndikimet në ajër

Proceset industriale në fabrikën e mobilëve mund të shkaktojnë ndotjen e ajrit përmes emetimeve të gazrave të ndryshëm të dëmshëm për shëndetin njerëzor. Përveç kësaj, prodhimi dhe përpunimi i materialeve si druri dhe plastika mund të shkaktojnë tym dhe poluante të tjera.

5.2 Ndikimet në tokë

Toka si element themelor natyror është një sistem i përbërë ekologjik i cili nga veprimet e ndryshme mund të vjen deri te degradimi i vlerave themelore karakteristike të saja. Në fazën e shfrytëzimit të fabrikës kemi ndikime minimale në tokë, pasi që fabrika është e izoluar dhe të gjitha punimet kryhen brenda saj, ndikimet mund të vinë nga grumbullimi i mbeturinave nga fabrika.

5.3 Ndikimet në ujë

Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut është sepse, proceset e prodhimit mund të sjellin shumë mbeturina dhe produkte të mbetura, si dhe ndotje të ujërave të ndryshme në zonën përreth fabrikës. Kjo mund të ketë ndikim negativ në ekosistemin e ujërave të ndryshme dhe të ndikojë në faunën dhe florën e tyre.

5.4 Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë

Sipas analizave të bëra deri tani në lidhje me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës mundë të vjen deri te ndikimet në florë dhe faunë. Mirëpo sipas gjendjes faktike në teren respektivisht në lokacionin e fabrikës nuk kemi zhdukje të vegjetacionit pos nga sipërfaqet nën objekte. E njëjta do të vlente edhe për faunën që do të thotë se nuk pritet të ketë ndikime negative, se fauna edhe ma herët nuk ka ekzistuar në këtë lokacion sepse fabrika e mobileve është ndërtuar në lokacionin që kanë ekzistuar biznese dhe vendbanime.

5.5 Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Hapësira ku është ndërtuar fabrika e mobileve nuk ka ndikim negativ në popullatën e zonës pasi që lokacioni ku është bërë ndërtimi i fabrikës është zonë ndërtimore. Në të kundërtën, ka ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të zonës dhe ndihmon në mbështetje përmes punësimit të komunitetit lokal.

5.6 Ndikimet nga zhurma

Në domenin e mbrojtjes së mjedisit zhurma paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrim të njeriut në punë etj. Lokacioni i stacionit të fabrikës me objektet përcjellëse është i ekspozuar zhurmës së krijuar nga qarkullimi i automjeteve. Sipas gjendjes faktike të fabrikës në lokacionin e analizuar mundë të konstatojmë se niveli zhurmës i shprehur në dB do të jetë nën vlerën e lejuar.

5.7 Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund tëndodhin në çdo etapë të procesit të operimit si:

- Lëndimet e punëtorëve gjatë kryerjes të aktiviteteve ndërtuese
- Gjatë aktivitetit të riciklimit dhe deponimit të mbeturinave
- Gjatë aktiviteteve transportuese,
- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga mekanizmi punues,
- Mundësia e zjarrit, etj.

Mirëpo, gjatë aktivitetit të operimit, mekanizmi punues do të jetë gjithnjë i mirëmbajtur, dhe imonitoruar nga ekspertë të lëmive përkatëse.

5.8 Ndikimi mjedisor nga mbeturinat

Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi i tyre - mbeturinat të cilat gjëndërohen gjatë aktivitetit të fabrikës së mobileve, të ashtuquajtura mbeturinat komunale deponohen në kontejner dhe pastaj bartën me kamionë nga kompanitë e licencuar, të cilat i dërgojnë në deponit regjionale për trajtim të mbeturinave.

Tabela 2. Përshkrimi i deponimit të mbeturinave sipas katalogut shtetëror

Mbeturinat	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit
150103	Druri	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
150107	Çelqi	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
150101	Letra dhe Kartoni	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
150103	Plastika	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
150106	Ambalazhe prej materialeve tjera	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina

Përshkrimi i magazinimit apo deponimit të mbeturinave - gjatë aktivitetit të fabrikës së mobileve, bëhet magazinimi i përkohshëm i mbeturinave të ngurta komunale të cilat grumbullohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim. Mbetjet urbane deponohen në kontejner dhe menaxhohen nga kompania lokale e qytetit, si mbetjet urbane tjera. Menaxhimi i mbeturinave - klasifikimi dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave Kompania e fabrikës së mobileve e bënë në bazë të rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina. Mbeturinat e ngurta komunale, grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.

5.9 Trashëgimia Kulturore

Si pas hulumtimit të materialeve përkatëse dhe nga informatat e siguruar në teren dhe Komunë, në lokacionin e ngushtë, ku gjendet fabrika e mobileve “PALMA” SH.P.K. në lokacionin e komunës së Gjilanit, nuk kemi monumente të trashëgimisë kulturore, historike e natyrore të cilat eventualisht do të ndikoheshin apo rrezikoheshin nga ushtrimi i veprimtarisë së fabrikës së prodhimit të mobilëve. Në lokacionin me të largët përreth fabrikës, aktivitetet e kompanisë “PALMA” SH.P.K. nuk kanë ndikime mjedisore dhe rreziqe esenciale në hapësirë.

6. PERSHKRIMI I METODAVE PER VLERSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE

Metodat te cilat janë përdorur për Vlerësimin e pasojave Mjedisore paraqiten si me poshtë:

Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike menaxhimi i trajtimit të çështjeve mjedisore. Si e tillë, ajo plotëson dhe përforcon një metodë sistematike në menaxhimin e përgjithshëm të një organizate; dhe organizatat me një menaxhim të shëndoshë përgjithësisht kanë një performancë më të mirë përmes një metode proaktive dhe të përgjithshme për zgjidhjen e aspekteve të veprimeve të saj. E kundërta e menaxhimit sistematik është reagimi ndaj vendimeve të marra rregullimi i gjërave kur ato prishen, të kuptuarit se si duhet vepruar kur ka një kërcënim të gjobave dhe padive ose kur përballësh nga konkurrentë më të efektshëm. Marrja e vendimeve të shpejta rrallë është një menaxhim i mirë. Në disa raste, organizatat i përfshijnë Sistemet e Menaxhimit të Mjedisit, sepse ata tashmë e kishin një sistem të mirë menaxhimi; në raste të tjera Sistemi i Menaxhimit Mjedisor çon në një menaxhim të përgjithshëm më të mirë duke hapur rrugën përmirësimit të përgjithshëm të veprimeve, dhe futjen e praktikave të mira të menaxhimit aty ku ato nuk kanë ekzistuar më parë. Në rastin e Sistemeve të Menaxhimit të Mjedisit, ka edhe përfitime të veçanta: kursime në kosto, përgatitja e organizatës për tregjet e së nesërme, përmirësimi i marrëdhënieve me autoritetet, zvogëlimi i rrezikut në aspektin e detyrimeve mjedisore, përmirësimi i motivimit të punonjësve, përmirësimi i shëndetit në punë dhe një performancë më të mirë mjedisore.

Kursime në kosto: Sistemet e Menaxhimit Mjedisor kërkojnë praktika për parandalimin e ndotjes, që në mjaft organizata sjellin kursime financiare. Në një fabrikë prodhimi pa aktivitete të mëparshme mjedisore, shpesh gjysma e ndotjes mund të parandalohet me investime të vogla dhe me procese të thjeshta përmirësimi ose me një qeverisje të mirë të brendshme. Në vendet Evropiane, tarifat e nënshtruara të shkarkimit dhe tarifat për hedhjen e mbeturinave janë shpesh herë mjaft më të larta se kostoja e aktiviteteve për parandalimin e ndotjes, në këtë mënyrë gjëndërohen përfitime financiare. Gjithashtu veprimtaritë dhe teknologjitë për të përmirësuar rendimentin e energjisë, si sistemet efektive të ndriçimit apo gjeneratorët elektrike dhe pompat shpesh janë me leverdi. Kjo do të thotë se ato gjenerojnë kursime në kosto.

Zvogëlimi i rrezikut: Menaxhimi sistematik i rrezikut është një detyrë e përgjithshme për çdo organizatë, dhe një Sistem i Menaxhimit Mjedisor do të mbështetë menaxhimin e rreziqeve nga dhe drejt mjedisit, që mund të parashtrajnë një rrezik për të ardhmen e vetë organizatës, p.sh. nëpërmjet emetimeve që nuk janë të pranueshme për mjedisin ose aksidente

që mund të çojnë në detyrime mjedisore ose dëmtim të reputacionit. Shqyrtimi fillestar mjedisor është gjithashtu një vlerësim i rreziqeve mjedisore, duke qenë se ai vlerëson pasojat dhe mundësinë e ndikimeve mjedisore. Plani i veprimit që rrjedh, dhe aktivitetet e tjera të zbatimit të sigurojnë mjetet për të menaxhuar këto rreziqe, duke u përpjekur në reduktimin si të mundësive të tyre dhe të efekteve negative.

Përputhje me legjislacionin: Organizatat në Ballkan dhe Evrope, kryesisht ato të përfshira në prodhim, veprojnë në mjedis mjaft të rregulluar: ata duhet të pajtohen me një legjislacion mjedisor të komplikuar. Gjithmonë e më shumë, aktivitetet e rrezikshme për mjedisin kanë nevojë për leje mjedisore. Për një organizatë, pajtimi me legjislacionin mjedisor është një detyrë e rëndësishme, meqenëse mos-pajtimi mund të çojë në detyrime dhe pasoja ligjore për përfaqësuesit ligjorë të organizatës – drejtuesit e lartë të saj. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor ndihmojnë në sigurimin e përputhshmërisë ligjore, pasi ato sigurojnë një bazë për identifikimin e legjislacionit të përshtatshëm, kërkesat e zbatueshme dhe kontrollon përputhshmërinë brenda organizatës. Kjo metodë sistematike me përputhshmërinë ligjore ndihmon gjithashtu në përmirësimin e marrëdhënieve të organizatës me autoritet mjedisore.

Marrëdhënie më të mira me publikun e gjerë: Aktivitetet e organizatave jo qeveritare dhe protestat publike kundër projekteve që mund të dëmtojnë mjedisin, tregojnë se ndryshimet në shoqëri po ndodhin në nivel global dhe lokal. Konventa Aarhus ndihmon publikun që të ketë një zë në vendimet politike që prekin cilësinë e këtij mjedisi, i ofron publikut akses të lirë në informacion, të drejtën e pjesëmarrjes dhe të drejtën e gjykimit për çështjet mjedisore. “Palët e interesuara” si rezidentë, grupet e interesit, media, klientët dhe çdo lloj grupi tjetër apo individ me interes në një çështje, janë tani pjesë e realitetit të një organizate, dhe mënyra më e mirë për tu sjellë me ta është fitimi i besimit nëpërmjet një informimi dhe komunikimi të rregullt dhe të besuar. Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit ju ndihmon në përgatitjen e të dhënave dhe informacionit që ju duhen për këtë proces komunikimi, ndërsa certifikatat dhe raportimi i rregullt do të mbështesin procesin e fitimit të besimit.

Përmirësimi i motivimit të punonjësve: Një nga rezultatet më të paparashikuara në anketat e organizatave që kanë zbatuar Sistemet e Menaxhimit Mjedisor është përmirësimi i motivimit të punonjësve. Punonjësit përfitojnë drejtpërdrejt nga efektet anësore si përmirësim i shëndeti në punë dhe i kushteve të sigurisë, por gjithashtu ata kujdesen për mjedisin.

Përgatitja e organizatës për tregjet e së nesërme: Ka dy tipe kryesore presionesh që do të ndryshojnë tregjet e së ardhmes: Së pari, kufizimet e botës natyrore – çështje si ngrohja globale, pamjaftueshmëria e ujit dhe humbja e biodiversitetit- do të ndrydhin veprimet e bizneseve. Së dyti, bizneset përballen me një spektër në rritje të klientëve që janë të shqetësuar për mjedisin. Ato biznese që përballen më mirë dhe që i gjejnë një zgjidhje këtyre sfidave, do të mundin konkurrentët e tyre. Duke rritur ndërgjegjësimin mjedisor brenda organizatës suaj, një Sistem i Menaxhimit Mjedisor do të ndihmojë në zbatimin e hapave të nevojshme si eko-projekti, në mënyrë që të zhvillohen procese dhe produkte që do të jenë të përshtatshme për tregjet e së nesërme, të cilat do të jenë më të ndërgjegjësuara për mjedisin.

7. PERSHKRIMI I MASAVE

Sipas analizës së bërë mbi ndikimin e fabrikës së mobileve në mjedis, si dhe në bazë të vlerësimit të kompleksit i cili është i ndërtuar dhe rekomandimeve të dhëna në këtë raport, fabrika e mobileve **“PALMA” SH.P.K.** në Rrugën Lufta e Gjilanit 44, Komuna Gjilan, me veprimtarinë kontinuele të sajë, nuk rrezikon mjedisin në maste të palejueshme, sepse janë realizuar shumë nga parakushtet e nevojshme për mbrojtjen adekuate të mjedisit, por megjithatë duhet të parashihet që në rast se vjen deri te ndotja duhet të ndermirren masat për parandalimin apo së paku zvogëlimin e ndikimeve negative që shpijnë deri te rrezikimi i mjedisit jetësor. Me qëllim të zvogëlimit të mëtejshëm të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut në fabrikën për prodhimin e mobileve në rrethanat e jashtëzakonshme dhe të rregullta.

7.1 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër

Për të minimizuar ndikimin e prodhimit të mobilëve në cilësinë e ajrit, kompania **“PALMA” SH.P.K.** mund të ndërmarrin disa masa, përfshirë përdorimin e teknologjive më të pastër për përpunimin e materialeve, instalimin e sistemeve të filtrimit të ajrit, përdorimin e substancave alternative më të pastër për pikturimin dhe prerjen e mobilëve, dhe sigurimin e ventilatorit të mjaftueshëm në ambientet e brendshme të fabrikës. Menaxhimi i mbeturinave të lëndëve të përdorura në prodhim dhe mbajtja nën kontroll të proceseve të përdorura mund gjithashtu të ndihmojë në zvogëlimin e ndotjes së ajrit.

Megjithatë gjatë operimit do të merren edhe këto masa:

- Mirëmbajtje e hapësirës manipuluese,,

- Kujdesi maksimal gjate procesit te transportit,
- Mirëmbajtjen e rregullt te makinerisë se punës dhe makinerisë lëvizëse-motorike.

7.2 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë dhe në tokë

Ndërtimi dhe operimi i një fabrike të mobilëve mund të ketë ndikime në burimet ujore dhe në tokë, por ka disa masa dhe praktika të cilat mund të ndihmojnë në zvogëlimin e këtyre ndikimeve:

- Përdorimi i teknologjive të pastërta: Investimi në teknologji të pastërta dhe efikase në përdorimin e ujit dhe energjisë mund të ndihmojë në zvogëlimin e ndikimit në burimet ujore dhe në tokë. Për shembull, sistemet e rimëkëmbjes së ujit dhe sistemet e riciklimit të ujit mund të zvogëlojnë përdorimin e ujit të freskët dhe ndotjen e ujërave të ndryshme.
- Menaxhimi i mbeturinave: Implementimi i sistemeve të efektshme për menaxhimin e mbeturinave në fabrikë mund të ndihmojë në zvogëlimin e ndikimit në tokë. Për shembull, riciklimi i mbeturinave druri dhe plastike për të përdorur në prodhimin e mobilëve të reja mund të zvogëlojë sasinë e mbeturinave që shkaktohet.
- Përdorimi i materialeve të riciklueshme: Zgjedhja e materialeve të riciklueshme për prodhimin e mobilëve mund të ndihmojë në zvogëlimin e ndikimit në tokë. Kjo mund të përfshijë përdorimin e drurit të ricikluar dhe materialeve të tjera të riciklueshme për të zvogëluar shfrytëzimin e burimeve natyrore.
- Monitorimi i ndotjes së tokës dhe ujërave: Implementimi i sistemeve të monitorimit të ndotjes së tokës dhe ujërave në përputhje me standardet ligjore dhe ambientale do të ndihmojë në identifikimin dhe zvogëlimin e burimeve të ndotjes.
- Bashkëpunimi me komunitetin lokal: Bashkëpunimi me komunitetin lokal për të adresuar shqetësimet e tyre në lidhje me ndikimin e fabrikës në tokë dhe burimet ujore është gjithashtu i rëndësishëm. Kjo mund të përfshijë diskutimin e masave mbrojtëse dhe ofrimin e transparencës në lidhje me operacionet e fabrikës.

Për të zvogëluar ndikimin në tokë dhe burimet ujore, është e rëndësishme që fabrikat e mobilëve të kuptojnë dhe të implementojnë praktika të qëndrueshme të prodhimit, si dhe të respektojnë dhe të përmbushin standardet ambientale të aplikueshme. Bashkëpunimi me autoritetet lokale dhe angazhimi në projekte të mbrojtjes së mjedisit mund të ndihmojë në promovimin e një mjedisi më të qëndrueshëm për të gjithë.

Në dobi të minimizimit të ndikimeve në tokë, siç është cekur edhe me lart nga ky aktivitet nuk pritet te ketë ndikime te mëdha ne toke. Në afërsi të hapësirës ku është ndërtimi i fabrikës, nuk ka burime sipërfaqësore te ujit te cilat përdorën për pije dhe burime të ujërave nëntokësore të cilat do të mund të dëmtoheshin nga aktivitetet e kësaj veprimtarie dhe me këtë mund të kolaudojmë se ndikimet do të jenë minimalë.

7.3 Masat për mbrojtje nga zhurma

Fabrika e mobileve, gjatë ushtrimit te aktivitetit te saje nuk shkakton zhurme ose mund te shkaktoje një zhurme shume te vogël e cila është brenda kufijve te lejuar. Parcela ku është e ndërtuar fabrika e mobileve është afër rrugës regjionalë Gjilan-Kamenicë dhe zhurma me e madhe behet nga lëvizja e makinerive qe lëvizin, prandaj zhurma qe krijohet nga fabrika e mobileve të kompanisë “PALMA” SH.P.K. është thuajse me e vogël se makinat lëvizës ne rruge. Megjithatë operatori duhet te marr te gjitha masat e parapara sipas ligjit dhe akteve nen ligjore për parandalimin dhe zvogëlimin e zhurmës ne kuadër te normave te lejuara, duhet te kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet te cilat prodhojnë zhurmën . Gjithashtu ndërmarrja e masave për mbrojtje nga zhurma në një fabrikë te mobilëve është e rëndësishme për të siguruar që ambientet e punës të jenë të sigurta dhe për të reduktuar ndikimin e zhurmës në shëndetin e punonjësve.

Këtu janë disa masat që mund të merren për të mbrojtur punonjësit nga zhurma në një fabrikë e mobilëve:

Identifikimi i Burimeve të Zhurmës: Identifikimi i burimeve kryesore të zhurmës në fabrikë, si makineritë e prerjes, pajisjet e përdorura për montim, ose proceset e pikturimit.

Përdorimi i Makinerive dhe Pajisjeve të Vëna në Punë: Investim në makineri dhe pajisje që kanë nivel të ulët të zhurmës ose përdorni izolim akustik për të reduktuar emetimin e zhurmës së tyre.

Vendosja e Barrierave Akustike: Vendosni barrierë akustike përreth burimeve të zhurmës për të reduktuar përhapjen e zhurmës nëpër ambientet e punës.

Përdorimi i Mbrojtjes Personale: Mundësoni përdorimin e mbrojtjes personale, si tapa të veshit, fasha të veshit, ose kufje të zhurmës për punonjësit që punojnë në ambientet me nivele të larta të zhurmës.

Rregullimi i Orarit të Punës: Në raste të caktuara, mund të konsiderohet rregullimi i orarit të punës për të reduktuar ekspozimin e punonjësve ndaj zhurmës, duke i lejuar ato të punojnë në orare më të pakta apo në momente kur nivelet e zhurmës janë më të ulëta.

Edukimi dhe Informimi i Punonjësve: Sigurohuni që punonjësit të jenë të informuar për rreziqet e zhurmës dhe për mënyrat e mbrojtjes nga ajo, duke ofruar trajnime dhe udhëzime për përdorimin e pajisjeve të mbrojtjes personale dhe praktikave të sigurisë në punë.

Monitorimi i Niveleve të Zhurmës: Kryeni monitorimin e rregullt të niveleve të zhurmës në ambientet e punës për të identifikuar rritje të papritura të zhurmës dhe për të marrë masa korrektuese nëse është e nevojshme.

Menaxhimi i Ambientit të Punës: Përmirësoni dizajnin e ambientit të punës për të reduktuar përhapjen e zhurmës dhe për të krijuar hapësira më të qeta pune, duke përfshirë izolimin e zonave të punës me nivele të larta të zhurmës.

Këto masa për mbrojtje nga zhurma mund të përdoren për të siguruar një ambient të sigurt dhe të shëndetshëm pune për punonjësit në një fabrikë të mobilëve dhe komunitetin lokal.

7.4 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë

Parcela në lokacionin në të cilën është ndërtuar fabrika e mobileve të kompanisë “PALMA” SH.P.K., nuk ka ndikim negativ në peizazh, florë dhe faunë e vendbanimit në fjalë dhe regjionit në përgjithësi.

7.5 Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë

Në afërsi të zonës së ku është e fabrika e mobileve të kompanisë “PALMA” SH.P.K., mund të sjellë përfitime në nivelin e punësimit në zonën e re dhe të rrisë aktivitetin ekonomik. Megjithatë, ai gjithashtu mund të shoqërohet me sfida sociale dhe ekonomike për komunitetin lokal, siç është konkurrenca për burimet dhe pronat vendase.

7.6 Masat për mbrojtje nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore

Në operimin e një fabrike të mobilëve, është e rëndësishme të marrësh masat e duhura për të minimizuar rreziqet dhe aksidentet mjedisore. Këto masat përfshijnë strategji për të mbrojtur ajrin, ujin, dhe tokën, si dhe për të adresuar çdo rrezik të mundshëm për shëndetin e punonjësve dhe komunitetit lokal. Këtu janë disa masa të rëndësishme për mbrojtjen nga rreziqet dhe aksidentet mjedisore nga një fabrikë e mobilëve:

- Instalimi i sistemeve të filtrimit të ajrit nëpër ndërtesën e fabrikës dhe nëpër pajisjet industriale për të kapur dhe të hequr substancat e dëmshme dhe polutantet nga ajri që dalin në atmosferë. Kjo përfshin përdorimin e filtërve të ajrit të lartësisë së lartë dhe të efektshëm të HEPA-s për të kapur grimcat e vogla dhe të dëmshme.

- Përdorimi i proceseve të qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve të prodhimit të mobilëve, duke përfshirë riciklimin dhe kthimin e tyre në procese të tjera, si dhe heqjen e sigurt të mbetjeve të dëmshme.
- Monitorimi i përhershëm i përmbajtjes së pajisjeve kimike në ambientet e punës dhe në ujët e shkarkuar për të siguruar që nivelet e tyre janë brenda kufijve të lejuar dhe që nuk ka rrezik për shëndetin e punonjësve dhe mjedisin.
- Sigurimi i trajnimeve të rregullta dhe të rëndësishme për personelin në lidhje me praktikën e sigurisë në vendin e punës, përdorimin e pajisjeve mbrojtëse, dhe masat e marrë për të minimizuar rrezikun e aksidenteve dhe rreziqeve mjedisore
- Kryerja e testeve të rregullta dhe monitorimit të cilësisë së ujit të shkarkuar dhe ajrit të dalë në atmosferë për të verifikuar se nivelet e ndotjes janë brenda kufijve të lejuar dhe që nuk ka ndikim negativ në ambientin e përgjithshëm.
- Hartimi i planeve të emergjencës dhe përgatitja e personelit për t'u përballur me situata të mundshme emergjente, si p.sh. shpërthime kimike, ndërprerje të fuqisë, apo ndonjë aksident tjetër i mundshëm.
- Bashkëpunimi dhe raportimi i rregullt me autoritetet lokale dhe organizatat e mjedisit për të adresuar çdo shqetësim të mundshëm mjedisor dhe për të përcjellë standarde të larta për mbrojtjen e mjedisit.

Këto masa të mbrojtjes janë esenciale për të siguruar që një fabrikë e mobilëve të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme dhe të sigurt për punonjësit, komunitetin lokal dhe përreth.

7.7 Masat rehabilituese

Pas përfundimit të aktiviteteve në fabrikën e mobileve, kjo varet nga investitori, se sa do të vazhdojë me këtë projekt, nëse nuk vazhdohet me këtë, atëherë objektet ekzistuese duhet të largohen nga lokacioni, bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi të inerteve. Të gjitha mbetjet e mbeturinave të ngurta dhe ato të inerteve që ekzistojnë në sipërfaqet e lokacionit si shtresa e dheut të kontaminuar pa tjetër duhet të largohen dhe të bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa më kompakte, ashtu që të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit gjegjësisht nga realizimi i proceseve të deponimit dhe shitjes së mobileve. Zgjedhja e modelit të rikultivimit

varet nga: Qëllimi i rekultivimit i cili nënkupton sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues dhe të mbjellën të lashtat periodike të cilat kultivohen në rrethinë të lokalitetit dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem

7.8 Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve

Komponenti mjedisore	Potenciali për ndikim negativ	Veprimi që shkakton ndikimin	Masat që duhet të ndërmerren
Ajri	Ka potencial të vogël për ndotjen e kualitetit të ajrit.	Ajri ndikohet kryesisht gjatë emetimeve të gazrave të ndryshëm të dëmshëm për shëndetin njerëzor.	Përdorimin e teknologjive më të pastër për përpunimin e materialeve, instalimin e sistemeve të filtrimit të ajrit, përdorimin e substancave alternative më të pastër për pikturimin dhe prerjen e mobilëve, sigurimin e ventilatorit të mjaftueshëm në ambientet e brendshme të fabrikës.
Uji dhe Toka	Në zonë nuk ka ujëra sipërfaqësore. Potencial për ndikimin ekziston të dheu dhe ujërat nëntokësore	Rreziku më potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe ndotja e dheut është sepse, proceset e prodhimit mund të sjellin shumë mbeturina dhe produkte të tjera të cilat mund ta ndotin tokën,	Fabrika e mobileve përdor materiale të riciklueshme të cilat riperdoren perseri: Menaxhimin e mbeturinave.
Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni,	Potencial minimal, nuk ka zona të rrezikuara ose në	Sipërfaqja ku është ndërtuar fabrika e mobileve nga kompania “PALMA” SH.P.K. është sipërfaqe	Me që në vendin ku është ndërtuar fabrika e mobileve nga kompania “PALMA” SH.P.K. është zonë ndërtimore ku ka biznese dhe shtëpi

fauna, Zonat e mbrojtura të natyrës)	zhdukje.	e madhe dhe kjo mund të ndikoj në shkallen e mikrosistemit.	banimi atëherë ka florë dhe faune shume pak te zhvilluar. Mirëpo nuk ka të dhëna për ndonjë lloj të rrallë, apo të pazakonshëm të florës apo faunës, ndikim është minimal, dhe pothuajse jo relevant.
Zhurma	Potencial minimal	Nga ky aktiviteti fabrika e mobileve nga kompania “PALMA” SH.P.K. ka potenciale te vogla te shkaktimin te zhurmë,	Mirëpo niveli i zhurmës nuk do të jetë i atillë që të ketë ndikim te madh në ambientin jashtëm. Zhurma me e madhe behet nga rruga magjistrale e cila është e ngjitur me parcelat e kompanisë.
Shëndeti i qytetareve dhe konsumatorëve	Potencial relativ	Në kushte jo të duhura mirëmbajtjes se hapësirës manipuluese.	Te gjitha pajisjet te cilat mund te kenë ndikime ne shëndetin e punëtorit dhe qytetareve do t’iu kushtohet rëndësi e veçan ne mirëmbajtjen e tyre.

7.9 Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimin e mbeturinave - klasifikimin dhe mënyrën e magazinimit të përkohshëm të mbeturinave Kompania fabrika e mobileve e bene ne bazë te rregullave dhe kushteve të përcaktuara me Ligji për Mbeturinat Nr.08/L-071 (2022) për ndryshim dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-060 (2012) për mbeturina. Mbeturinat e ngurta komunale, grumbullohen, klasifikohen dhe të vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.

8. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE

Sa i përket aksidenteve apo katastrofave të mëdha që lidhen me fabrikën e prodhimit të mobileve nga kompania “PALMA” SH.P.K nuk kemi fare rrezik, rrezik minimal mund të kemi vetëm nga energjia elektrike e cila mund të djeg ndonjë makine apo ndonjë instalim elektrik, por edhe për këtë kompania i ka marruar të gjitha masat duke siguruar aparate për fikjen e zjarrit dhe hidrantë të brendshme për fikjen e zjarrit.

9. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi – Pas ndërtimit të fabrikës së prodhimit të mobileve, shihet qartë se ky aktivitet nuk paraqet trysni mjedisore monitorim i detyrueshëm dhe permanent i treguesve mjedisor janë të domosdoshëm. Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen në mënyrë të rregullt dhe për çdo rast duhen të merren masat e nevojshme komform ligjeve dhe të njoftohen organet kompetente.

Raportimi - do të kryhet nga personi përgjegjës i autorizuar nga menaxheri i kompanisë, gjegjësisht nga ekspertet e kompanisë brenda dhe jashtë sajë. Në raport, eventualisht do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjitha parametrave të cilët do të jenë kërkuar në Pëlqimin Mjedisor (lejen mjedisore e cila lëshohet pasi të pajisemi me Pëlqim Mjedisor nga MMPHI).

10. PËRFUDNIMI

Në bazë të tërë asaj që është thënë më lart mund të konkludohet se ndikimet në mjedis nga zhvillimi i aktiviteteve të Fabrikës së Prodhimit të Mobileve është mjaft i vogël e disa edhe fare të pa përfillshme, që do të thotë se zhvillimi i kësaj veprimtarie në këtë lokacion është në interes të komunitetit lokal, qendror dhe është mjaft miqësorë për mjedisin.

Kompania “**PALMA**” SH.P.K. duhet ti respektoj të gjitha masat e dhëna me sipër për të pasur një ambient të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm për mjedis.

Duke u bazuar në **Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis** i cili është baza kryesore ligjore të cilit ju kemi referuar, Shtojca 1 e këtij ligji, paragrafi 10.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është përshkrimi i projektit, identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis si dhe përshkrimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis dhe mund të konkludohet se zhvillimi i kësaj veprimtarie në lokacionin në fjalë nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve, gjithashtu ndikimet në tokë, ujë, ajër, peizazh dhe pamjen vizuale, pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, konstatohet se ato mund të minimizohen në nivel të lakmueshëm, ose edhe të eliminohen në fazën e rehabilitimit të hapësirave të degraduara të formuara nga parkingjet e shtruara me zhavorr.

Kompania “**PALMA**” SH.P.K. duhet respektuar të gjitha masat e prezantuara me sipër për ujë, ajër dhe tokë.

Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme për raport të VNM-së dhe i propozojmë institucionit kompetent përkatësisht Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturë (MMPHI), për dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Mjedisor sipas kërkesës së investitorit “**PALMA**” SH.P.K., Komuna e Gjilanit.

11. ANALIZA KOST – BENEFITE E PROJEKTIT NË FORMËN TABELARE:

KOSTO INVESTIVE E PROJEKTIT		
1	Çmimi total i Objektit te Privatizuar	455,000.0€
2	Sharra për prerjen e drurit	35,000.0€
3	Makina e ABS	45,000.0 €
4	Makina për prerje CNC	70,000.0 €
5	Makineria për lyerjen e drurit	50,000.0 €
6	Furra	100,000.0 €
7	Makineria për paketim	90,000.0€
8	Sistemi i ajrimit dhe pluhurit	55,500.0 €
9	Makinat për ngarkim dhe shkarkim 3 copë	21,000.0€
10	Makinat për transport	50,000.0€
Kosto totale investive		971,500.00 €

“PALMA” SH.P.K.

Gjilan

12. LITERATURA E PERDORUR

Lista e bibliografisë (referencave) së burimeve të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e përfshira në raport.

- Te dhënat nga Investitori,
- [Plani-Zhvillimor-Komunal-në-Gjilanë-2015-2023.pdf \(rks-gov.net\)](#)
- [Kërko dhe paraqit - KGP \(rks-gov.net\)](#)
- [OpenStreetMap.](#)
- [Palma mobilje \(palma-mobilje.com\)](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS \(rks-gov.net\)](#)

